



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

DREJTORIA UJITJE-KULLIM

Nr. _____ Prot

Maliq, më _____.____.2019

Drejtoria Ujitje-Kullim, transferuar me VKM Nr.1108, datë 30.12.2015 “Për transferimin, nga Ministria e Bujqësisë, Zhvillimit Rural dhe Administrimit të Ujërave të bashkitë, të infrastrukturës së ujitjes dhe kullimit, të personelit dhe të aseteve të luajtshme e të paluajtshme të Bordeve Rajonale të Kullimit”, pranë Bashkisë Maliq.

Kjo drejtori ushtron veprimtarinë e saj mbështetur në ligjin Nr.139/2015 “Për vetëqeverisjen vendore”, Ligjin Nr. 24/2017 “Për administrimin e ujitjes dhe kullimit” dhe aktet ligjore e nënligjore të përcaktuara në rregulloren e brendshme të Bashkisë Maliq “Për organizimin, funksionimin, detyrat, përgjegjësitë dhe kompetencat e administratës, së Bashkisë Maliq”.

Drejtoria Ujitje-Kullim ka si objektiva:

- Të njohë, organizojë e drejtojë gjithë personelin e drejtorisë me vizionin e bashkisë për sistemin e ujitjes dhe kullimit mbi bazën e legjislacionit në fuqi.
- Të përcaktojë detyrat dhe përgjegjësitë e secilit në këtë sistem.

Misioni:

- Pastrim dhe mirëmbajtjen e kanaleve kullues të II-të dhe të III-të dhe veprat ujore.
- Pastrim dhe mirëmbajtje të kanaleve ujitëse e ushqyesit e rezervuareve.
- Kontrollon e mirëmban digat e rezervuarëve dhe mban në gatishmëri shkarkuesit katasrofikë dhe ujëlëshues.
- Organizon dhe drejton ujitjen në sezonin veror.

Drejtoria Ujitje-Kullim është e organizuar në dy sektorë: Sektorin Ujitje-Kullim dhe Sektori Mekanik.

Spektori Ujitje-Kullim merret me planifikimin e ndjekjen e punimeve dhe sigurimin e organizimin e ujit për ujitje.

Spektori Mekanik merret me ndjekjen e punimeve, mirëmbajtjen e mjeteve dhe harxhimin e karburantit.

Drejtoria Ujitje Kullim mbi bazën e programit vjetor të hartuar që në fillim të vitit 2018, duke patur për bazë inventarizimin e objekteve dhe problematikat që ekzistojnë në to, ka hartuar planet e punës mujore për çdo sektor, duke u mbështetur në shfrytëzimin maksimal të mjeteve dhe personelit që ka në dispozicion kjo agjenci. Njëkohësisht në bashkëpunim me prokurimet publike kemi realizuar ndërtimin e veprave shumë të domosdoshme për përmirësimin e ujitjes dhe kullimit në bashki.

Si rezultat i këtij planifikimi nga agjencia janë është kryer ky aktivitet:

Gjatë periudhës janar-dhjetor është punuar me 4 eskavatorët dhe kemi arritur të pastrojmë: 195 520 ml kanal(duke realizuar 96.5% të planit vjetor), vendosjen e 585 ml tombinosh dhe sistemin e 56 000 ml argjinature njëkohësisht dhe rrugë për kalimin e mjeteve, sipas tabelave më poshtë duke pasqyruar edhe punën e viteve të mëparshme:

Tabela e punimeve të kryera

Nr	Nj.Administrative	Kanale të pastruar			Parashikimi 2018 (ml)	Realizimi për vitin 2018 (%)
		2016 (ml)	2017 (ml)	2018 (ml)		
1	Libonik	19012	40343	46804	35450	132
2	Pirg	26118	28191	45536	82840	55
3	Vreshtas	14126	42749	34379	36240	94,9
4	Pojan	31250	65188	68801	48110	143
	Shuma	90506	176471	195520	202640	96,5

Nr.	Nj.Administrative	Vendosje tombinosh (ml)			Sistemi rruge (ml)
		2016 (ml)	2017 (ml)	2018 (ml)	
1	Libonik	110	73	208	23000
2	Pirg	61	8	169	6000
3	Vreshtas	57	26	105	6000
4	Pojan	41	68	103	21000
	Totali	269	175	585	56000

Po kështu u bënë ndërhyrje të domosdoshme në riparimin e portave te Diga Zëmlak dhe ndërhyrja në rrjetin e furnizimit me ujë te Kaskada e Shamollit.

U është ofruar shërbimi fermerëve në zënien e një sasive të konsiderueshme pritash me volum rreth 4500-5000 m³.

Nëpërmjet programimit të punës nga ana jonë u bë e mundur që me fillimin e sezonit të ujitjes tu siguronim ujë fermerëve në çdo parcelë ku kishin nevojë. Si rezultat i kësaj, gjatë sezonit të ujitjes u ujitën 755.7 hektarë tokë.

Tabela e ujitjes

Nr	Njësia Administrative	Sipërfaqja e ujitur (ha)
1	Libonik	215,1
2	Pojan	131,7
3	Vreshtas	283,3
4	Pirg	125,8
	Shuma	755,7

Gjithashtu është punuar për vendosjen e 48 paneleve për ndërtimin e 3 urave të reja mbi kanalën e ujërave të larta Leminot dhe 6 urave në Kolektorin e Sovjanit, nga subjekti privat i kontraktuar për realizimin e këtyre punimeve dhe riparimin e 4 urave të dëmtuara.

Njëkohësisht ka përfunduar veshja me mur guri e 160 ml të kanalit të ujërave të larta Leminot.

Jemi drejt përfundimit nga subjekti privat të kanalit kullues në mes të fshatit Pojan me gjatësi 712 ml bashkë me 7 urëkalimet. Po nga kjo firmë është tenderuar dhe po vazhdohet për përfundimin e ndërtimit dhe vendosjes të 17 portave në kanalet kryesorë ujitës që furnizohen nga diga e Zëmbllakut dhe bëjnë, kompletimin dhe magazinimin e një sasive prej 30 portash të përmasave të ndryshme të cilat do të vendosen nga ana jonë në momentin e kërkesës nga ana e fermerëve për funksionimin e kanaleve ujitës që ka në administrim bashkia jonë (në Nj. Administrative Pojan, Vreshtas, Pirg).

Veç punimeve të kryera për vënien në gatishmëri të rrjetit kullues gjatë sezonit dimëror, menjëherë pas sezonit të ujitjes, janë marrë masa për kontrollin, sigurimin e të gjitha argjinaturave të kanaleve të dytë, të parë dhe kolektorë, që nënkupton hapjen e gjithë pritave që kemi bërë për sezonin e ujitjes dhe përfundimin e argjinaturave përkatëse.

Një rëndësi e veçantë i është kushtuar mbajtjes në kontroll dhe funksionimit normal të veprave ujëmbledhëse (rezervuarë) që kanë konsistuar në kontrollet teknike të linjës funksionale të shkarkuesve, funksionin e saraqineskave të shkarkimit, shkarkuesve katastrofikë dhe si rezultat, janë vënë në kontroll të gjithë objektet ujëmbledhëse dhe janë bërë riparimet e nevojshme në saraqineska e ujëlshuesit e rezervuarëve Klocë, Çaušli dhe pastrimi i shkarkuesve katastrofikë natyralë të këtyre rezervuarëve.

Njëkohësisht po punohet për evidentimin e problematikave të ujëmbledhësve në njësitë administrative Moglicë dhe Gorë, pavarësisht se nuk kanë skema ujitje, po planifikohen masa për ndërhyrjen dhe rehabilitimin e problemeve që ata kanë.

Është në përfundim e sipër vendosja e 3 portave në kanalet rreth Pyllit të Fazanëve, përveç portave të mëdha në kolektorin e Sovjanit që sigurojnë mbrojtjen nga përmytja të

zonës torfike, po ashtu dhe pjesës problematike tek Pylli i Fazanëve në një sipërfaqe rreth 140 hektarë.

Duke bashkëpunuar me Drejtorinë Rajonale të Ujitjes dhe Kullimit Korçë u arrit që të kryhet pastrimi i pjesës problematike të lumit Devoll, nga Pylli i Fazanëve deri poshtë urës së Maliqit, në një gjatësi rreth 2.5 km. Njëkohësisht dhe pastrimi i Kolektorit të Sovjanit në një gjatësi 11.22 km.

Si rezultat i këtij bashkëpunimi për arsye të domosdoshmërisë që kishte pastrimi i një pjese të kolektorit të Sovjanit, nga Ura e Kishnikut deri në fund të fshatit Shëngjergj, që përfshin zonën e Bregasit, u bë pastrimi i kolektorit në një gjatësi 2.3 km.

Nga Agjencia Ujitje-Kullim është bërë e mundur plotësimi i të gjitha kërkesave të komunitetit për pjesën ku është nomenklatura jonë.